



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 170/4 Prot.

Tiranë, më 21/3/2013

Lënda: Urdhër për Kontrolluesin *Gjykata e Apelit*, Tiranë.

U R D H E R
Nr 09, datë 21/03/2013

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "*Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "*Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të Kontrolluesit *Gjykata e Apelit*, Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të urdhrin nr.53 datë 11.03.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye inspektimi administrativ pranë kontrolluesit *Gjykata e Apelit*, Tiranë me objekt:

- Verifikimi i ankesës së shtetases A.V drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e cila lidhet me publikimin e Vendimit Nr. 1347 (Nr. 1389 Akti), datë 02.12.2011, të publikuar në faqen e tuaj zyrtare në internet, vendim i cili mbart të dhëna personale të saj.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe provat e administruara nga inspektimi administrativ, si dhe pretendimet e kontrolluesit si vëren se:

Vendimi nr. 1347 datë 02.12.2011, objekt i verifikimit të këtij inspektimi administrativ, që i përket shtetases A.V., e cila ka bërë ankim më datën 06.03.2013 pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është publikuar në faqen zyrtare në, ashtu siç është në dosjen fizike të çështjes pa marrë masat e duhura për bërjen anonime të të dhënave personale të subjekteve që përfshihen në këtë vendim. Qëllimi i publikimit të këtij vendimi është transparenca dhe informimi publik.

Komisioneri vlerëson se duke bërë publike të dhënat personale të subjekteve të përfshirë në këtë vendim shkelet privatësia e këtyre subjekteve të të dhënave personale, nuk respektohen dhe garantohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti e drejta e ruajtjes së jetës private, të drejta të cilat janë të mbrojtura nga neni 8 i Konventës Evropiane për "*Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut*" si dhe ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" duke qene në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” neni 2...
“Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtën e ruajtjes së jetës private”
- Udhëzimin nr.15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor”, Kreu IV “ Publikimi i të Dhënave Personale”.

Konstatohet gjithashtu se nga Gjykata e Apelit Tiranë nuk janë marrë masat e duhura teknike e organizative për zbatimin e Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor”.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

URDHEROJ

1. Në zbatim të nenit 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, dhe Kreut IV të Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor”:
 - Të realizohet në mënyrë të menjëhershme, anonimizimi apo inicializimi i të dhënave personale që i përkasin subjektit ankues, A.V., të përfshirë në Vendimin Nr. 1347 (Nr. 1389 Akti) të Gjykatës së Apelit Tiranë, datë 02.12.2011, të publikuar në faqen e tuaj zyrtare në internet.
2. Të merren të gjitha masat e duhura teknike dhe organizative për zbatimin e Udhëzimit nr.15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Për Përpunimin dhe Publikimin e të Dhënave Personale në Sistemin Gjyqësor” për të realizuar anonimizimin apo inicializimin e të dhënave personale që i përkasin subjekteve të përfshira në vendimet gjyqësore që publikohen në faqen zyrtare në internet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

